

RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR FËMIJËT NË SITUATË RRUGE

Periudha raportuese korrik –shtator 2015

Në zbatim të **Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërministrorë mes Ministrisë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve**, datë 12.06.2015. nr. prot 3430 dhe Planit të Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge”, 2015-2017, vijon procesi i ndërhyrjes për fëmijët dhe familjet në 4 bashki në vend, Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Fier. Në Tiranë ka nisur që në qershor 2014, kurse gjatë 2015 plani po zbatohet në 3 bashki të tjera.

Deri tani është hartuar dhe ndarë me aktorët e përfshirë në zbatim të planit një raport vjetor për periudhën **qershor 2014 –qershor 2015** dhe raporti **3 muaj mars-qershor 2015**.

Prej fillimit të 2015 puna për zbatimin e PV e filluar në bashkitë Elbasan, Durrës, Fier ka ecur paralel me punën që bëhet në Tiranë.

- **Puna identifikuese në terren**

Në **Tiranë** vijon me një ritëm të stabilizuar tashmë procesi i nisur prej 2014 për integrimin e fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge. Skuadrat e terrenit funksionojnë në 11 Njësi Administrative në Tiranë të përbëra nga Njësitë e Mbrojtjes së fëmijëve dhe punonjës socialë të organizatave “ARSIS”, “SHKEJ”, “Të ndryshëm të barabartë”, “ Qendra Ditore për fëmijët në situatë rruge- Save the children, si dhe të mbështetur nga Bërthama koordinuese. Ato operojnë në terren sipas njësave vendore në bazë të kalendarit të paracaktuar nga Bërthama e cila në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme ka realizuar koordinimin e skuadrave dhe aktorëve të tjerë të nevojshëm. Nga skuadra e terrenit kryhen 25 dalje në javë, në muaj 100 dalje. Skuadrat e terrenit përveç zonave të nxehta kanë monitoruar edhe rrugë dytësore si dhe rrugica pallatesh, duke qenë se vihet re një spostim i vendndodhjes së fëmijëve në situatë rruge. Monitorimi i terrenit gjatë sezonit të verës është mbuluar gjatë orareve paradite (8:00-16:00) dhe në oraret e pasdites (19:00-21:00) çdo ditë të javës. Gjatë kësaj periudhe është konstatuar rënie e numrit të rasteve të fëmijëve në situatë rruge krahasuar me periudha të mëparshme për arsye të sezonit veror i cili ka ndikuar në lëvizjen e këtyre familjeve drejt zonave bregdetare. Në muajin shtator Bërthama dhe NJMF-të kanë qenë pjesë e takimeve dhe aktiviteteve të organizuara në komunitetin e liqenit në bashkëpunim me Organizatën ARSIS. NJMF –të dhe dhe përfaqësues nga Zyra e Punës kanë informuar komunitetin mbi çështjen e punësimit.

Në **bashkinë Durrës** gjatë këtyre 3 muajve, skuadrat e terrenit të përbëra nga përfaqësues të institucioneve nga NJMF, drejtoria e shërbimeve sociale në bashki, qendra komunitare Nish Tulla, dhe nga organizatat : Qendra për Zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen”, Shoqata e Grave me probleme sociale, qendra ditore “Dielli i mëngjesit”, kanë identifikuar dhe trajtuar raste

të fëmijëve në situatë rruge. Puna në terren ka qenë e limituar gjatë muajit gusht për shkak të lejeve dhe pushimeve verore për shumicën e specialisteve në institucione. Identifikimet janë përqëndruar më shumë në zonën Shëtitores dhe atë të plazhit si zonat me të nxehta. Fëmijët dhe familjet e identifikuar janë kryesisht nga rrethet Elbasan dhe Fier të cilat ose vendosen për periudhën e verës në Durrës ose janë në lëvizje vajtje- ardhje çdo ditë nga këto zona. Fëmijët lypin ose shesin në të shumten e kohës të shoqëruar nga të afërm të tyre të rritur.

Në muajin Korrik, nisur nga numri i madh i fëmijëve që shisnin në zonën e plazhit në Durrës, skuadrat e terrenit të Tiranës iu bashkuan aksionit të organizuar nga Agjencia në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social në bashki dhe NJMF e Durrësit, institucionet vendore, organizatat që veprojnë në Durrës dhe organizata që veprojnë dhe ofrojnë shërbime në Tiranë. Gjithësej 21 persona u ndanë në 6 skuadra terreni të miksuara me përfaqësues nga Tirana dhe nga Durrësi u shpërndanë në terren për të shkëmbyer eksperiencën e, por dhe për t'ju ardhur në ndihmë profesionistëve në Durrës në identifikimin e raste të fëmijëve që lypin dhe shesin në këto zona. Një tjetër aksion i koordinuar nga Njësia për të Drejtat e fëmijëve, me pjesëmarrjen e 15 personave në 5 skuadar terreni, të mbështetura nga Eorld Vision identifikoi 32 fëmijë që shesin gjatë sezonit veror në Gjirin e Lalësit. Të gjithë fëmijët u kontaktuan, u bënë vizita në familje dhe u morën të dhëna për ta dhe familjet.

Gjatë muajit shtator kraportohet një rënie e konsiderueshme e numrit të fëmijeve që lypin, që lidhet me mbarimin e periudhes turistike dhe kthimin e fëmijëve dhe familjeve e në qytetet e origjinës.

Në bashkinë Elbasan ka vazhduar dalja e organizuar në terren, sipas kalendarit. Gjatë kësaj periudhe puna ka vijuar në monitorimin e rasteve që janë në proces menaxhimi si dhe të identifikimit të rasteve të reja. Për 17 rastet e identifikuar më parë, por që nuk janë kontaktuar prapë nga NJMF ka vijuar procesi i verifikimit duke u koordinuar me administratorët socialë dhe inspektorët e policimit të zonës ku janë identifikuar rastet. Gjatë punës në terren janë identifikuar 2 raste të reja, për të cilat, gjithashtu ka vijuar procesi i verifikimit, të cilat me gjithë monitorimin e kryer, ende nuk janë kontaktuar edhe pse është bashkëpunuar me SK të Tiranës dhe të Fierit.

Në bashkinë Fier, puna e skuadrave të terrenit ka vijuar normalisht në bazë të kalendarit. Për shkak të periudhës së lejeve vjetore, janë alternuar oraret e pjesëmarrësve të skuadrave për të mundësuar daljet në terren. Plani i identifikimit dhe mbrojtjes së fëmijëve në situatë rruge dhe vazhdimësia e procesit është miratuar dhe nga Kryetari i ri Bashkisë.

Çdo fillim muaji zhvillohet një takim i mekanizmit të koordinimit për të diskutuar për rastet e identifikuar dhe gjetjen e alternativave për mbështetje, pasi dihet që në bashkinë Fier mungojnë qendrat ditore që ofrojnë shërbime për fëmijët në situatë rruge.

Gjatë këtyre tre muajve janë identifikuar 6 raste fëmijësh. Këto fëmijë kanë qenë të pashoqëruar dhe janë parë në mënyrë të përsëritur në terren. Nga vlerësimi i bërë rezulton që janë fëmijë të komunitet rom që banojnë në një nga njësitë administrative të Fierit.

- **Zbatimi i planit të mbrojtjes së fëmijëve dhe menaxhimi i rasteve**

Tiranë: NJMF e Bashkisë Tiranë vazhdojnë punën për mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve. Secila NJMF ka organizuar planin e mbrojtjes së fëmijëve përmes takime të Grupeve Teknike Multidisiplinare(GTM). Shërbimet që janë ofruar janë : pajisje me certifikata, regjistrime në gjendjen civile, paketa ushqimore, mbështetje me grante për familjet, për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe, kopsht dhe shkollë, mbështetje me mjete didaktike, mbështetje me pagesa për qera banese. Në këtë proces janë mbështetur nga OJF, të cilët janë pjesë si e identifikimit ashtu dhe menaxhimit të rasteve, duke u bërë pjesë e GTM. Deri tani janë menaxhuar rastet e 53 familjeve dhe fëmijëve në situatë rruge.

Fokusi kryesor në këtë periudhë ka qenë puna për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve në situatë rruge në çerdhe, kopesht dhe shkollë. Agjencia , listat e fëmijëve në situatë rruge të hartura nga NJMF, në bashkëpunim organizatat i ka referuar pranë institucioneve përkatëse për të krijuar lehtësira në regjistrim në çerdhe dhe kopsht të fëmijëve. Lista e 47 fëmijëve të moshës 0 - 3 vjeç , për regjistrim në çerdhe është referuar pranë QZHEF Bashkia Tiranë, kurse lista prej 38 fëmijësh të moshës 3 - 5 vjeç i është referuar DAR. Regjistrimet në çerdhe kanë qenë të pakta për arsye të mungesës së kapaciteteve. Në kopsht është arritur te regjistrohet rreth gjysma e numrit të referuar.

Grupi i punësimit ka qenë në përpjekje të vazhdueshme për të mbështetur familjarët për mundësi punësimi, duke suportuar jo vetëm gjetjen e vendeve vakante, por dhe vazhdimësinë e punës për të punësuarit, ndërmjetësimin me punëdhënësit.

Në bashkinë Durrës është mbledhur 2 herë gjatë kësaj periudhe GTM për të diskutuar mbi problematikat dhe mbështetjen e rasteve. Tryezat teknike me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet si DAR, Shërbimi Social Rajonal, Shëndeti Publik, Policia,OJF, kanë diskutuar të gjithë rastet e identifikuar, nisur nga numri i madh i tyre. Për rastet e fëmijëve që banojnë në Durrës është bashkëpunuar me qendrën komunitare të Nishtullës dhe OJF që operojnë në afërsi të zonave të nxehta, si në plazh, kënetë etj. Është arritur që të merren në mbrojtje **10 fëmijët** të cilët nuk janë më në situatë rruge. Puna është fokusuar dhe në identifikimin dhe regjistrimin në shkolla të fëmijëve. Sfida kryesore e këtij procesi është numri i madh i rasteve që punojnë me shitje dhe lypje gjatë verës si dhe sigurimi i informacionit të saktë nga familjet në lëvizje. Rreth 60 fëmijë janë identifikuar deri tani, por që mendohet që numri është më i madh dhe shërbimet janë të pamjaftueshme. Për fëmijët në Gjirin e Lalësit është siguruar mbështetje me mjete shkollore, veshje dhe çanta për shkollë me mbështetjen e Terre des Homme.

Edhe pse në këtë periudhë ka më pak fëmijë në Bashkinë Durrës, në sezonin veror, nevojitet që bashkia Durrës, dhe të gjithë partnerët në Durrës të marrin përgjegjësi dhe masa më efikase parandaluese lidhur me shtimin e rasteve të fëmijëve që punojnë në stinën e verës.

Në bashkinë Elbasan gjatë periudhës 3 mujore për rastet e identifikuar dhe të kontaktuar nga NJMF janë hartuar planet e ndërhyrjes në takimet e GTM për të mbështetur fëmijët dhe familjet e tyre. Mbështetja ka konsistuar në referimin e fëmijëve për regjistrim në shkolla, kopshte, ndjekje dhe referim në shërbimet shëndetsore, sistemim i fëmijëve në qendrën rezidenciale të

Tjetër Vizion. Për familjet janë orfuar pako ushqimore, prindërit janë përfshirë në aktivitete dhe takime informuese, janë referuar për tek OJF për mikrokredi. Nga të dhënat rezultojnë që **8 fëmijë** nuk janë më në situatë rruge. Në proces menaxhimi janë **17 raste** fëmijësh dhe familjet e tyre.

Në bashkinë Fier, menaxhimi i rasteve është bërë përmes vizitash në familje dhe mbledhje e informacionit, kjo për shkak të të dhënave jo të sakta që ata japin, dhe për shkak të vështirësive në sigurimin e burimeve logjistike dhe mjeteve financiare për të mbështetur rastet. Kjo e vështirëson punën, pasi rastet që mbështeten, shpesh krijojnë varësi prej asaj çfarë u ofrohet.

GTM janë mbledhur rregullisht edhe pse ka patur mungesa nga disa aktorë, për shkak të periudhës së lejeve vjetore. Gjatë kësaj periudhe janë mbështetur **17 raste fëmijësh** dhe familjet e tyre.

Përsa i përket llojit të shërbimeve, kryesisht kanë qenë shërbime psikologjike këshilluese, integrim në skemën ndihmës ekonomike, përfshirje në skemat e hapjes së një biznesi, vetëpunësimit, integrimi në skemën e zyrave të punës për kurse profesionale dhe për punësim në subjekte private. Raportohet dhe rasti i parë i punësimit të një personi nga familjet në situatë rruge.

Në bashkinë Fier qendrat ditore nuk ofrojnë shërbime ndaj fëmijëve në situatë rruge, por janë ofruar shërbime nga organizata dhe fondacione si Terre des Hommes, Parlamenti Rinor, Kryqi I Kuq etj.

- **Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit**

Bërthama koordinuese për Tiranë dhe NJMF-të e bashkive të përfshira kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me strukturat e policisë dhe për raste kur ka pasur nevojë për ndërhyrje, të cilat nuk kanë pranuar ndihmën dhe mbështetjen e ofruar nga institucionet shtetërore. Në këto raste është kërkuar ndërhyrja e patrullës së policisë, me ndërhyrjen e pikës së kontaktit nga Drejtoria e policisë së Qarkut. Ka pasur raste që patrulla nuk është përgjigjur në kohë, apo nuk ka pasur të qartë se çfarë procedurash duhen ndjekur. Gjithësej janë referuar në polici për 18 raste shfrytëzimi të miturish, dy prej të cilëve në periudhën 3 mujore raportuese.

- **Bashkitë të tjera që kanë raportuar për fëmijë në situatë rruge.**

ASHMDF ka nxitur dhe inkurajuar NJMF e bashkive të gjithë vendit për të raportuar për raste të Grupeve Teknike Multidisiplinare të identifikuar dhe menaxhura në bashkitë përkatëse. Si rrjedhim pranë ASHMDF kanë ardhur informacione për raste të menaxhuara nga NJMF-të e Bashkive Vlorë, Shëngjin, Shkodër, që janë gjithashtu zona bregdetare dhe fëmijët zakonisht dalin për lypje apo shesin sende për pushuesit. Në bashkinë **Vlorë**, përveç punës identifikuese në terren janë menaxhuar dhe mbështetur 2 familje dhe fëmijët e tyre, me mbledhje dokumentacioni, ndihma në ushqime, veshmbathje, regjistrim në shkollë. Në bashkinë **Shkodër** në bashkëpunim me Save the Children janë mbështetur për integrimin në shkollë të 38 fëmijë

në situatë rruge. Informacion për menaxhim rastesh dha takime të GTM kanë ardhur dhe nga NJMF e bashkisë **Korcë** dhe **Cërrik**.

- **Regjistrime në shkolla, kopshte**

Duke vlerësuar regjistrimin dhe ndjekjen e shkollës nga fëmijët në situatë rruge si një proces shumë të rëndësishëm për riintegrimin e fëmijëve, ASHMDF ka pasur në vëmendje të veçantë regjistrimin e të gjithë fëmijëve në shkollë si dhe sigurimin që fëmijët të mos braktisin shkollën. Në këtë kuadër Agjencia ka kërkuar nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashkitë e përfshira Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier të identifikojnë fëmijët e paregjistruar në shkollë për vitin 2015-2016 në bashkëpunim me DAR, shkollat përkatëse dhe komunitetin. Në përgjigje NJMF-të dërguan listat e fëmijëve të identifikuar në situatë rruge të referuar dhe regjistruar në shkollë.

Në katër bashkitë e përfshira nga 284 fëmijë të referuar, 70 fëmijë janë regjistruar në shkollë dhe nga 41 fëmijët të referuar për kopësht 21 janë regjistruar dhe frekuentojnë kopshtin.

Raste të referuar të fëmijëve në situatë rruge për regjistrim në shkolla, janë raportuar dhe nga bashkitë e tjera në vend, në përgjigje të kërkesës zyrtare të Agjencisë, siç janë bashkia Shkodër(38), bashkia Cërrik,(4) bashkia Gjirokastër(4), bashkia Vlore(2), bashkia Bulqizë(1). **Deri tani në gjithë vendin janë referuar për regjistrim 333 fëmijë dhe janë raportuar që ndjekin shkollën 112 fëmijë në situatë rruge.**

DAR Tiranë i është kërkuar të shihen me prioritet rastet e regjistrimit të fëmijëve nga dy komunitet Paskuqan dhe zona e liqenit. Problematika e këtij komuniteti është largësia e banesave të tyre pranë shkollave më të afërta. Deri tani asnjë fëmijë i këtij komuniteti nuk ka frekuentuar shkollën për arsye të distancave të largëta nga vendbanimi. Lista përveç DAR është dërguar dhe Zyrës Arsimore Kamëz, por jemi ende në pritje të përgjigjes.

Nga listat e dërguara, u identifikuan që një numër fëmijësh ishin mbi 9 vjeç dhe nuk kishin ndjekur asnjëherë shkollën, për të cilët u kërkuar nga ASHMDF më shkresë zyrtare drejtuar MAS aktivizimi programeve të "Shansit të dytë" nga të gjitha DAR në vend. Ende nuk ka informacion dhe jemi në pritje për hapjen e klasva të shansit të dytë sipas Udhëzimit nr. 29, datë 02.08.2013 "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesëshme".

- **Pajisja me libra falas.**

Për të gjithë fëmijët në nevojë të regjistruar në shkolla, nga ASHMDF është kërkuar ndjekja e veçantë për pajisjen me tekste falas, në bazë të VKM Nr.212 date 16.3.2011 si dhe VKM datë 26 Gusht 2015, për pajisjen me tekste falas të kategorive në nevojë. NJMF- të bashkive të përfshira dhe të tjera si Lushnjë, Berat, Cërrik kanë referuar gjatë muajit shtator pranë Agjencisë rastet ku janë shfaqur probleme me shpërndarjen e teksteve falas për fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptianë dhe për fëmijët në situatë rruge. Në koordinim më MAS dhe DAR-et përkatës janë

zgjdhur problematikat e referuara nga në bashkëpunim me DAR-et përkatëse dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.

- **Databaza e rasteve të identifikuar dhe mbështetur**

Të dhënat për fëmijët e identifikuar dhe mbështetur përditësohen në databazën për secilën bashki. Bërthama ka përditësuar për çdo rast fëmije shërbimet që janë ofruar, duke nxjerrë dhe numrin e saktë të fëmijëve që janë marrë në mbrojtje dhe janë larguar nga rruga. NJMF-të e bashkive Durrës, Elbasan Fier, përditësojnë të dhënat mbi ecurinë e rasteve në databazën përkatëse. Databaza e përditësuar nga këto bashki dërgohet çdo muaj pranë ASHMDF. Të dhënat nga 4 bashkitë të cilat ruhen në databazën e qendëruar, shqyrtohen për rastet e lëvizjeve të fëmijëve dhe familjeve mes qyteteve.

Në databazën e bashkisë Elbasan është reflektuar qartë puna që është bërë me fëmijët dhe familjet. Gjithashtu NJMF e bashkisë Fier ka përshkruar në rubrikën përkatëse, punën që është bërë me familjet, kurse NJMF e Bashkisë Durrës, nuk e ka të reflektuar të gjithë informacionin konkret se çfarë është bërë me secilin rast.

- **Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për fëmijët në bashkitë e përfshira.**

Një ndihmë dhe kontribut të çmuar për identifikimin e fëmijëve dhe menaxhimin e rasteve kanë dhënë organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për fëmijët. Stafi i OJF është bërë pjesë e skuadrave të terrenit duke ndihmuar në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve dhe ofrim shërbimesh në qendrat ditore.

Në Tiranë, është bashkëpunuar me organizatat “ARSIS”, “SHKEJ”, “Të ndryshëm të barabartë”, “Fëmijët e Botës dhe Shqipërisë”, Qendra Ditore për fëmijët në situatë rruge- Save the children, Terre des Homme.

Në Elbasan është bashkëpunuar me organizatat “Ndihmë për fëmijët”, qendrën komunitare “Në dobi të Gruas Shqiptare”, “Tjetër Vizion, Terres des Hommes, “A 2 B “, “Një ëndërr më shumë” “Ndihma e Ëailheilmit” “Orët fatlume”- Karitas.

Në Durrës është bashkëpunuar me organizatatTDH; Eorld Vision, Qendra Komunitare “Sot Për të Ardhmen”, qendra “Dielli i Mëngjesit”, Shoqata “Në dobi të gruas Shqiptare, si dhe vullnetarë të cilët kanë qenë shumë aktivë në identifikimin dhe trajtimin e rasteve.

Në Fier është bashkëpunuar me Qendrën Sociale « Murialdo dhe Terre des homme.

Nisma vazhdon të gëzojë mbështetjen gjithashtu të organizatave ndërkombetare si UNICEF, OSBE dhe UNDP.

- Tabela e përmbledhur për ecurinë e punës në katër bashkitë e përfshira, Tiranë , Durrës, Elbasan, Fier.

Bashkia	Nr I skua drave te terrenit	Dalje në terren/ muaj	Nr fëmijëve të identifikuar	Nr. I rasteve të menaxhuar	Raste të referuar për regjistrim në shkollë		Raste të referuar për kopsht		Raste të referuar për çerdhe		Raste të referuar për punësim		Raste të ndjekjeve penale
					referuar	regjistruar	referuar	regjistruar	referuar	regjistruar	referuar	punësuar	
Durrës	1	8	68	22	9	7		1					
Elbasan	4	32	39	31	11	8	3	3			1	1	1
Fier	1	8	17	3	32	13							
Tiranë	11	100	361	165	232	42	38	17	47	7	72	42	17
Total	17	148	485	221	284	70	41	21	47	7	73	43	18